



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK  
DREJTORIA JURIDIKE DHE E VERIFIKIMIT**

**Të dhëna mbi Vendimin**

**Nr. 99, datë 05.10.2018**

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 13/3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar (në vijim "LPP"), në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "ORTI OIL" Shpk nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik.

**I. Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa):**

"ORTI OIL" Shpk me NIPT L33514204L, me adresë: Autostrada "Elbasan Metalurgji", kilometri i parë, 200 m nga QTO.

**II. Arsyet e fillimit të procedimit administrativ:**

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "ORTI OIL" Shpk ka nisur mbi bazën e kërkesës Nr. 2011 Prot., datë 22.06.2018, plotësuar me shkresën Nr. 2053/1 Prot., datë 24.07.2018, të dërguar nga Ujësjiellës Kanalizime Elbasan Sha, me të cilën ky i fundit i propozon APP-së nisjen e hetimit administrativ ndaj operatorit ekonomik "ORTI OIL" Shpk, për përjashtimin e tij nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, për keqinformim dhe paraqitje të dokumentave që përmbajnë të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi.

**III. Gjetjet:**

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e keqinformimit dhe paraqitjes së dokumentave që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, sipas parashikimeve të nenit 13/3/a të LPP.

#### **IV. Masat:**

Me Vendimin Nr. 99, datë 05.10.2018 Agjencia e Prokurimit Publik ka vendosur të përjashtojë për një periudhë 1 (një) vjeçare operatorin ekonomik "ORTI OIL" Shpk, nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, pasi ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese faktin që operatori ekonomik "ORTI OIL" Shpk, është tërhequr nga lidhja e kontratës dhe nuk ka përfituar fondet publike të saj, si dhe faktin që ky operator ekonomik nuk ka qenë i përjashtuar më parë nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

Gjithashtu, në vlerësimin e dhënies së masës së dënimit është mbajtur në konsideratë edhe fakti që, vlera e detyrimeve që rezultojnë të pashlyera ndaj organit tatimor nga verifikimi në sistemin C@TS subjekti "ORTI OIL" Shpk prej **1.383 lekë**, është një vlerë jo e konsiderueshme.